



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Председник Општине
Belediye Başkanı

01 Nr. 265/24 Dt. 22.04.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, për lejimin e shfrytëzimit të internetit nga Zyra e Tatimit në Pronë e Komunës së Prizrenit, për regjistrimin dhe verifikimin e pronave të paluajtshme në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Kontrata do të jetë trevjeçare (kontratë kornizë).
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Komunës së Prizrenit–pozicioni mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Sektori i Prokurimit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

